

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



01

MBAHET KONFERENCA "RINIA 2030" ME RASTIN E NJË VJETORIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me rastin e një vjetorit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë organizoi **konferencën "Rinia 2030" me qëllim llogaridhënien drejt të rinjve lidhur me masat dhe objektivat e ndjekura gjatë zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë.**

Konferenca në panele bëri bashkë mbi **20 aktorë të rendësishëm në ekosistemin e rinisë**: ministrat përgjegjës për pushtetin vendor, administratën publike, arsimin dhe sportin, sigurinë dhe rendin, kryetarin e Bashkisë së Beratit, drejtues të lartë të institucioneve zbatuese, agjencitë e OKB-së si UNDP, UNICEF, UNFPA, përfaqësues të mbështetësve strategjikë si AADF dhe World Vision, Ambasadorin e Bashkimit Evropian dhe përfaqësi të larta nga ambasadat italiane, franceze dhe gjermane. Përgjatë konferencës, të organizuar në 3 panele në përputhje me 3 qëllimet strategjike u diskutuan masat e ndërmarra në kuadër të fuqizimit të të rinjve dhe përfshirjes në vendimmarrje; edukimi, aftësimi, punësimi dhe nxitja e inovacionit rinor; dhe mirëqenia fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Në fund të paneleve të diskutimit, u mbajtën punëtoritë me pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe të rinjve nga Këshillat Vendorë Rinorë dhe Këshilli Kombëtar Rinor me qëllim identifikimin e sfidave për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Përgjatë ditës, u angazhuan **350 përfaqësues të organizatave për të rinjtë, grupe informale, biznese, përfaqësi ndërkombëtare, vetë të rinjtë e mandatuar për të përfaqësuar të rinjtë e vendit si pjesë e Këshillave Vendorë Rinorë dhe si pjesë e Këshillit Kombëtar Rinor**, si dhe aktorë të tjerë në fushën e rinisë.

Kjo konferencë u organizua me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Asistencës Teknike "Mbështetja e BE për Përfshirjen Sociale në Shqipëri".



02

PËRMBYLLET FAZA E TRAJNIMEVE PËR KONKURSION "TECHNOVATORS DHE SIPËRMRRËSIT E SË NESËRMES

Pas një turi trajnimesh për gjimnazistët në të gjithë Shqipërinë, më 20 shkurt, në qytetin e Elbasanit **u përmyll me sukses faza e trajnimeve për konkurset "TECHnovators" dhe "Sipërmarrësit e së Nesërmes", një nismë kjo e Tirana Business University, që këtë vit vjen me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.**

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me kryetarin e bashkisë Elbasan, Z. Gledian Llatja dhe përfaqësues nga TBU, në qendrën rinore të Elbasanit biseduan me një grup gjimnazistësh rreth këshillimit në karrierë, profesioneve të së ardhmes, krijimit të startup-eve dhe fushës së teknologjisë, nga ku të rinjtë morën informacione rreth mundësive për të zhvilluar një karrierë të suksesshme, dhe si ata mund të bëhen pjesë e konkurseve për të sjellë në jetë idetë e tyre inovatore për të pasur një impakt të qenësishëm në shoqëri.

Së shpejti do të mbahen **konkurset në çdo qark të vendit**, ku të rinjtë do të konkurojnë me idetë e tyre inovatore për të fituar çmime për të realizuar idetë e tyre, si dhe bursa të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHQIPTIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



03

SAMITI I QEVERIVE BOTËRORE 2024

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për të rinjtë dhe fëmijët mori pjesë në Samitin e Qeverive Botërore të mbajtur në Emiratet e Bashkuara Arabe në datat 12-14 shkurt. Në paraprirje të samitit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët takoi të rinjtë e Programit të Liderave të Rinj të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me të cilët u diskutua rreth politikave rinore, strategjive dhe mekanizmave për fuqizimin e të rinjve në të dy shtetet respektive me qëllim përmbushjen e OSHQ-ve.

Më tej, në Samitin e Qeverive Botërore, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në tryezën e rrumbullakët mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, **theksoi rëndësinë e kontributit të të rinjve, fuqizimin dhe angazhimin e tyre për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe ndau me të pranishmit strukturat e ngritura në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për përfshirjen e të rinjve shqiptarë në politikëbërje**, të cilat synojnë njëherazi edhe fuqizimin, edukimin dhe mirëqenien e të rinjve.

Shqipëria shihet si një model suksesi në rajon, por edhe më gjerë lidhur me masat e ndërmarra për fuqizimin dhe angazhimin e rinisë në vendimmarrje.



04

TRAJNIM PËR ORGANIZATA RINORE DHE PËR TË RINJTË PËR RRRITJEN E KAPACITETEVE

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të organizatave rinore në përthithjen e fondeve nga BE, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e trajnuesve më të mirë në këtë fushë, **organizoi trajnimin dy ditor me fokus në Programin European Erasmus+ me përfaqësues nga rreth 40 organizata rinore dhe për të rinjtë**.

Trajnimi dy ditor u realizua me qëllim rritjen e financimeve të jashtme në shërbim të të rinjve shqiptarë, si dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve në projektet dhe iniciativat e Bashkimit Evropian.

Përgjatë trajnimit, organizatat vendosën bazën e aplikimeve cilësore në përputhje me kërkesat e BE-së, **duke rritur në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundësitë për të rinjtë, si dhe duke fuqizuar organizatat për të rinjtë me qëllim ofrimin e më shumë zhvillimeve inovatore për të rinjtë**.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



05

MBAHET PANIRI I EDUKIMIT, TRAJNIMIT DHE PUNËSIMIT NË GJIROKASTËR

Në vijim të nismës "Panair Edukimi, Trajnimi dhe Punësimi në çdo qark", u realizua panairi i radhës në qarkun e Gjirokastrës, pas 7 panireve të tjera të mbajtura në Kukës, Sarandë, Vlorë, Tiranë, Korçë, Shkodër dhe Dibër. **Panairi i Gjirokastrës solli pranë rreth 300 të rinjve mbi 30 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinj, të cilët i prezantuan me një sërë mundësish për edukim, trajnim dhe punësim në përputhje me profilin e të rinjve dhe kërkesat e tregut në fushat si teknologjia, inovacioni, bujqësia, turizmi dhe zanatet.**

Nisma "Panair Edukimi, Trajnimi dhe Punësimi në çdo qark" e lançuar në muajin qershor 2023 nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zhvillohet në kuadër të plotësimit të qëllimit të dytë politik të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 me qëllim informimin e të rinjve mbi mundësitë që kanë në dispozicion për edukim, trajnim dhe punësim. Kjo nismë deri më tani ka **informuar rreth 2300 të rinj në 7 qarqe të vendit**, dhe do të vijojë edhe në qarqet e tjera me qëllimin për të shkuar pranë të rinjve të vendit tonë.



06

INAUGUROHET QENDRA RINORE MULTIFUNKSIONALE "TRY GJIROKASTRA"

Në kuadër të mbështetjes së ofruar për njësitë e vetëqeverisjes vendore për ngritjen ose rikonstruktivimin e infrastrukturës rinore, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në inaugurimin e **qendrës rinore multifunkionale "Try Gjirokastra" në qytetin e Gjirokastrës**. Kjo qendër ofron për të rinjtë ambiente bashkëkohore si kinema, hapësira kulturore, sociale dhe një hapësirë të veçantë për Këshillin Vendor Rinor, për të diskutuar dhe ofruar zgjidhje mbi çështjet që prekin të rinjtë e Gjirokastrës.

Qendra Rinore Multifunkionale "Try Gjirokastra" është një nga nëntë investimet e realizuara falë financimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nëpërmjet thirrjeve për grante për ngritjen e infrastrukturës rinore.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHITIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



07

ECURIA E PROGRAMIT EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA

Në vijim të monitorimit të Programit Ekipe Sportive në Shkolla me qëllim evidentimin e impaktit të tij tek fëmijët dhe të rinjtë, përgjatë muajit shkurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar një vizitë në shkollën 9- vjeçare "Ahmet Gashi" në Tiranë dhe një vizitë në shkollën "Asim Zeneli" në Gjirokastrë.

Në bisedën e zhvilluar me ekipin U-10 dhe të shkollës 9-vjeçare që zhvillojnë stërvitje tre herë në javë, fëmijët dhe të rinjtë eveidentuan se me anë të stërvitjeve kanë mësuar teknika të reja për sportin dhe se ndihen gati për kampionatet që do të zhvillohen në vijim, si dhe gjithashtu tashmë shpenzojnë kohën pas mësimit në mënyrë cilësore duke u trajnuar në sport.

Programi i Ekipeve Sportive në Shkolla ka filluar zbatimin në vitin 2022 duke përfshirë më shumë se 10 mijë fëmijë dhe të rinj në disiplinën e volejbollit dhe basketbollit. Në vitin 2023 ka filluar pilotimi i Programit Ekipe Sportive në Shkolla U-10 duke përfshirë mbi 1500 fëmijë të grupmoshës 8-10 vjeç.



08

NDËRGJEGJËSIMI MBI SIGURINË KIBERNETIKE TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me përfaqësuesit e AKCESK, ASHDMF dhe OSBE në Shqipëri, si dhe pjesëmarrjen e të rinjve nga gjimnazet zhvilluan një diskutim të hapur lidhur me fenomene si bullizmi dhe krimet kibernetike, por edhe metodologjitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe masat e ndërmarra me qëllim parandalimin dhe trajtimin e këtyre fenomeneve.

Fëmijët dhe të rinjtë janë informuar mbi rreziqet e internetit me anë të një fushate ndërgjegjësimi të ndërmarrë nga AKCESK dhe ASHDMF në shkolla, ku fokusi mbetet te informacioni mbi platformat për raportimin e incidenteve online, si isigurt.al dhe ALO 116 111.

